



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

VENDIM
Nr. 573, datë 07.12.2021

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË NGRITJES NË DETYRË NË
GJYKATËN E APELIT GJIROKASTËR, PËR POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E
TË DREJTËS CIVILE, TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 389, DATË 07.10.2020,
TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikën 3, të nenit 90 dhe nenin 95, të Kodit të Procedurave Administrative, në pikën 2, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “a”, pika 2, të nenit 61, në shkronjën “ç”, të nenit 86, në pikën 3, të nenit 97 dhe në nenin 100, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, pasi konstatoi tërheqjen e kandidatit të vetëm në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Gjyrokastër, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e tij nr. 389, datë 07.10.2020, duke vlerësuar se objekti për të cilin kjo procedurë ka nisur është bërë i pamundur, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Gjyrokastër, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 389, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR